

**STATUTI DHE AKT THEMELIMI I SHOQËRISË
“DINCI GROUP” SH.P.K.**

(Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar)

Në bazë të ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për tregetaret dhe shoqëritë tregtare”, dhe, ligjit nr.9723. date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” une i nënshkruari shpall si më poshtë vijon:

**Neni 1
FORMIMI I SHOQËRISË**

Sot ne daten 14.06.2024 formohet shoqëria e quajtur **“DINCI GROUP” SH.P.K.** (Qe ketu e me poshte referuar si “Shoqeria”, e cila themelohet nga Ortaku si me poshte:

Z.Mikel Tarusha, shtetas shqiptar, i biri i Josif, lindur me 26.08.1987 ne Elbasan, banues ne adresen: Lagjja Kala, rruga Egnatia, Elbasan, identifikuar me karte identitetit Nr.036210723, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar
dhe

**Neni 2
QENDRA E SHOQËRISË**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresen: **Rr: “Kol Popa”, ZK 8524, Lagjja Kala, Elbasan, Shqiperi.**

Shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale, zyra perfaqesimi, ne te gjithe vendin gjate aktivitetit te saj, brenda ose jashte territorit te vendit.

**Neni 3
KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE**

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar që prej datës së regjistrimit të saj në Qendren Kombetare te Bisnesit (QKB).



Shoqeria mund te perfundoje, te vihet ne likujdim perpara ketij afati aktivitetin e saj me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

- 1.Ofrimin e sherbimeve te akomodimit, dhoma me qira tip airbnb.
- 2.Ofrimin e sherbimeve ne fushen e turizmit dentar. Sherbime Online marketingu dhe kordinimi ne fushen e turizmit dentar.
- 3.Projektim dhe zbatim projektesh ndertimi, konsulence ligjore dhe administrative per prona, konsulence ne shitblerjem pasurish te palujtshme, guida turistike.
- 4.Analiza dhe vleresim te biznesit, biznes plane, vleresime risku dhe studime fizibilitetit. Monitorim dhe oponence te pergjithshme, verifikim i parametrave teknike, social mjedisore, dhe ligjore. Projektimi, konsulenca dhe zbatimi i projekteve ne sektorin e energjise, duke perfshire por pa u kufizuar te gjitha llojet e energjive te zbatueshme. Rilevime topografike. Shitblerje pasurish te palujtshme. Punime dhe projekte gjeodezike, supervizion dhe topogjeodezike ne objekte inxhinierike. Sherbime logjistike, transport, distribucion, dhenien me qira te automjeteve, sherbime marketingu. Aktivitete komisioni dhe brokeri, aktivitete. Konsulence ne fushen e ndertimit dhe operimit te pasurive te paluajtshme dhe te luajtshme. Veprimtari ne sigurimin, transmetimin, shperndarjen, importimin, eksportimin dhe tregtimin me shumice ose pakice brenda dhe jashte vendit te energjiseelektrike. Kerkimi, projektimi, keshillimi dhe zbatimi ne fushen e ndertimit. Shitja me shumice dhe pakice e te gjitha llojeve te artikujve ne ndryshem , dhe suvenireve , produkte turistike etj etj
5. Konsulence dhe sherbime ne fushen e shoqerise se informacionit, teknologjise se regjistrave te shperndare, sistemeve te informacionit, komunikimit, dhe menaxhimit. Zhvillim software dhe administrim projektesh. Konsulence ne fushen e drejtesise gjeresisht ne fushen e te drejtes tregtare, civile, administrative etj. Konsulence ligjore ne fushen qeverisjes se korporatave, bashkimit dhe perthithjes se shoqerive tregtare, prokurimeve publike, koncesioneve dhe privatizimeve, pronesise intelektuale si dhe konsulence ne te gjitha fushat e tjera te se drejtes ne pergjithesi. Sherbime perfaqesimi, ndermjetesimi, arbitrazhi dhe lobingu. Konsulence fnanciare, bankare dhe tregtare, konsulence ne fushen e investimeve, konsulence ne fushen e telekomunikacioneve dhe teknologjive, ne fushen e turizmit dhe ndertimit, industrise etj. Konsulence mbi ristrukturimin e organizimin financiar dhe ne fushen e tatim taksave.



6.Per kryerjen e aktivitetit te saj, Shoqeria mund te kryeje cdo operacion tregtar, operacione qe lidhen me pasurite e luajteshme dhe te paluajteshme, financiare dhe kreditore si edhe te bleje apo shese apo te marre apo jape me qera pasuri, si edhe te kete interesa apo pjesmarrje ne shoqeri, ente, konsorciume, te themeluara apo ne themelim e siper, qe kane nje objekt te ngjashem apo funksional ne arritjen e qellimeve te Shoqerise, si dhe te ofroje garanci, garanci bankare, te marre hua dhe te ofroje garanci, pasurore apo personale, ne favor te te treteve. Me ne pergjithesi, Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve te saj.

Neni 5

EMRI DHE SELIA E SHOQERISE

Kjo shoqëri eshte person Juridik Privat me emertimin e saj **DINCI GROUP SH.P.K.** Shoqeria mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë kapitalin sipas vendimeve të Ortakut .

Neni 6

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali fillestar i shoqerise është 10.000 (dhjete mije) leke i perbere nga 1 kuote me vlere 10.000(dhjete mije) leke, zoteruese 100% te kapitalit te shoqerise.

Kapitali zotërohet 100% nga ortaku si me poshte :

Z.Mikel TARUSHA, shtetas shqiptar, i biri i Josif, lindur me 26.08.1987 ne Elbasan, banues ne adresen: Lagjja Kala, rruga Egnatia, Elbasan, identifikuar me karte identitetit Nr.036210723, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar i cili zoteron 100 % te kapitalit fillestar

Ortaku mund te vendose te rrisi kapitalin e shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe me vendim te Ortakut. Detyrimet e ortakut kundrejt shoqerise do te mbulohen vetem me pjesen e kapitalit te paguar prej tij. Ortaku nuk do te kete asnje pergjegjesi tjeter per detyrime te tjera te shoqerise.



Shoqëria nuk pergjigjet per detyrime te marra per qellime qe nuk perputhen me ato te paracaktuara nga ky Statut, si edhe per detyrime te marra nga Ortaku ne emrin e tij personal.

Neni 7

REGJISTRIMI I SHOQERISE

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky Statut si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar në datën e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Bisnesit (QKB) sipas nenit 43 te ligjit 9723 date 3.5.2007.

Neni 8

KALIMI I KUOTAVE DHE E DREJTA E PARABLERJES

Kuotat e kapitalit te shoqerise si dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen nepermjet :


- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) shitblerjes se kuotave
- c) trashegimise
- d) dhurimit
- e) cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes nga casti i kalimit te kuotave deri ne castin e regjistrimit te kalimit.

- Pjeset e kapitalit mund t'u transferohen te treteve teresisht ose pjeserisht, vetem me vendim te Ortakeve te shoqerise.

Neni 9

Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, emri i administratorit, duhet te jete te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri dhe që ju drejtohen te treteve. Shoqëria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.

Karuska.

Neni 10

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet kontraktore

Organet e shoqerise jane:

- 1- Asambleja e Ortakeve te Shoqerise
- 2- Administratori/et

Neni 11

KOMPETENCAT E ORTAKUT

Per menyren e drejtimit dhe ushtrimit te aktivitetit te shoqerise, Ortaket shprehen me vendime per gjithshka qe eshte ne kompetencat e tyre te pershkruara si me poshte:

- Kane te drejte te bejne ndryshime ne statut.
- Percaktojne politikat tregetare te shoqerise
- Kane të drejtë të miratojnë bilancin e shoqerise dhe te bejne ndarjen e fitimit.
- Ata emerojne ose shkarkojne administratoret, likujduesit ekspertet kontabel te autorizuar.
- Mbikeqyrin zbatimin e politikave tregetare nga administratoret, perfshire pregatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise
- Miratimin e pasqyrave vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Miratojne zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit.
- Percaktojne shperblimin per administratorin, ekspertet, revizoret kontabel.
- Miratojne pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Perfaqesojne shoqerine ne gjykate dhe kryejne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Kryejne riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miratojne rregullat procedurale te mbledhjeve te asamblese.

J. Karusha.

- Miratojne lidhjen e kontratave per dhenie dhe marrje te drejtash ose ekskluzivitet per tregtimin dhe prodhimin e mallrave te shoqerise si dhe kontrata ne lidhje me organet shteterore per pjesmarrjen ne tender, ankande ose aktivitete te tjera te rendesishme.
- Realizojne blerje, shitje si dhe tjetersim te pasurive te palujtshme te shoqerise etj.

Neni 12

VENDIMET E ASAMBLESE

Marrja e vendimeve te Ortakut regjistrohen ne regjistrin e vendimeve te Ortakeve , mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim. Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshem .

Neni 13

THIRRJA E ASAMBLESE

Asambleja e pergjithshme thirret sa here qe shte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise. Mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit.

Asambleja e pergjithshme thirret nga Adminsitratoret ose nga ortaket te cilet perfaqesojne te pakten 5 % te totalit te votave ne Asamblene e Pergjithshme te Shoqerise Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nepermjet postes elektronike 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese. Njoftimi ne te dyja formate e mesiperme duhet te permbaje vendin, daten ,oren e mbledhjes dhe rendin e dites.

Neni 14

PJESEMARRJA NE VENDIME

Cdo ortak, ne rastet kur shoqeria do te kete me shume se nje ortak, ka te drejte te marre pjese ne vendime si dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe Ai/ajo zoteron.

J. Karashta.

Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Ne rastin kur asambleja duhet te vendose per ceshtje qe kerkojne shumice te kualifikuar si per shembull ndryshime ne statut, zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit te regjistruar, shperndarja e fitimeve, riorganizimi dhe shperndarja e shoqerise, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 50% te kuotave, dhe votojne pro tre te katertat e votave te ortakeve pjesemarres personalisht, ose qe votojne me shkrese apo me mjete elektronike

Neni 15

A D M I N I S T R I M I

Shoqeria administrohet nga nje administrator te cilet caktohen ne statutin e shoqerise dhe me pas nga Asambleja e Ortakeve. Administratori/et qendrojne ne detyre per nje periudhe jo me te gjate se 5 vjet me te drejte riprteritje kohore dhe ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftesie nga ana e tyre, Asambleja e Ortakeve vendos shkarkimin e tyre per shkaqe te arsyeshme.


Administratori/et detyrohen te kryejn te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqerise duke zbatuar politikat tregetare te vendosura nga asambleja e pergjithshme.

Ato kujdesen per mbajtjen sakte dhe te rregullt te dokumenteve, dhe te librave kontabel te shoqerise.

Ato pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor te shoqerise, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise, dhe se bashku me me propozimet per shpernarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumente para asamblese se pergjithshme per miratim.

Ato kane te gjitha kompetencat per te vepruar me tretet ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqerise u'a jep shprehimisht Ortakeve te Shoqerise.

Administratori/et kane te drejte te nenshkruajne per kapitalin e shoqerise, kontrata te ndryshme, per furnizime publike private, cdo lloj operacioni bankar, te veproje me cdo lloj instituti bankar publik e privat, te ndermarre veprime gjyqesore, transaksione te ndryshme, etj, tij. Administratori/et mund te japin prokura ne kufijte qe i lejon Asambleja e Ortakeve per kategori te caktuara veprimesh.



Te gjitha veprimet e tjera duke perfshire pagesa dhe detyrime per tu paguar ose veprime me insitucionet bankare ku perfshihen transferta bankare dhe terheqje parash qe do te ndermerren nga Administratori/et per llogari te shoqerise, eshte e nevojshme dhe e detyrueshme nenshkrimi i Administratori/eve se bashku me vulen e shoqerise, ne menyre qe keto veprime te jene te detyrueshme per shoqerine.

Administrator i shoqerise eshte **Znj.Zoica Zharkalli**, shtetase shqiptare, e bija e Nikoll, lindur me 04.02.1994 ne Selanik, Greqi, banues ne adresen: Lagjja Kala, rruga Egnatia, Elbasan, e pajisur me karten e identitetit Nr.038189624, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar. Ajo do ta ushtroje kete detyre per nje periudhe 5 vjecare.

Neni 16

MARREDHENIET E PUNES

Mardheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektojne rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendeshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Neni 17


KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i shoqerise.

Neni 18

EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL

Kontrolli mbi veprimtarine e shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e shoqerise i besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet.Ortaket caktojne dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.



Neni 19

VITI FINANCIAR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit. Administratori/et marrin masat lidhur me perlllogaritjen e rezultateve ekonomike të fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit të ceshtjeve të mesiperme si dhe shlyerjen e detyrimeve, të ardhurat e tjera do të kalojnë ortakut të shoqërisë.

Neni 20

SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Ne rast se shoqëria shperndahet për çdo lloj arsye Ortaket përcaktojnë mënyrën e likuidimit, emerojnë një ose më tepër likuidator dhe përgatitin të gjitha dokumentet e nevojshme për c'regjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

NENI 21

ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti do të zgjidhen me mirkuptim dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë midis palëve të interesuar.

Ne rast se nuk do të arrihet një zgjidhje me mirkuptim të mosmarrëveshjes, ajo do të besohet Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Neni 22

DISPOZITA E PERGJITHSHME

Përsa është shprehur në këtë statut i referohemi ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007 I Ndryshuar “Për Regjistrimin e Biznesit”. Çdo ndryshim bëhet në përputhje me këtë Statut dhe nuk prek personalitetin juridik të kësaj shoqërie.

Statuti është hartuar në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe.

ORTAKET E SHOQERISE “DINCI GROUP” SH.P.K

Z.MIKEL TARUSHA

Mikel Tarusha.
MTarusha.